



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**

**Data 19.11.2025**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: KARBURANT DHE VAJ (BLERJE GAZ I LENGHEM (PER QSK)**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Gaz i lëngshëm propan 09122110-4

Gaz i lëngshëm butan 09122210-5

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**6.172.530 (gjashtë milion e njëqind e shtatedhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë) lek pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4.;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të parashikuar të kontratës.**

---

**Argumentimi:** Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

### **2.2 Kapaciteti teknik:**

**2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.2.2** Ofertuesi duhet të jetë i licensuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

Për sa me sipër duhet të paraqesë **Licence VIII.1.A** të lëshuar nga QKL ose **Licence për tregtimin me pakice të gazit të lëngshëm** lëshuar nga organet e pushtetit vendor.

**Argumentimi:** “Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me Ligjin Nr. 9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në V.K.M Nr. 129, datë 18.03.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, të gazit e nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me V.K.M Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.2.3** Ofertuesi duhet të dorëzojë një raport analize të cilesise se gazit të leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknike dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet të jetë leshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes së tenderit.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6.c .*

*Kriteri i mesipërme u vendos me qëllim që të vërtetohet se gazi që operatori tregëton është konform standarteve në fuqi.*

**2.2.4** Ofertuesi të disponojë një autobus në pronësi ose me qera për të cilin duhet të paraqesë: certifikatën e pronësisë të mjetit, lejen e qarkullimit , Sigurimin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

Në rast se është marrë me qera të paraqesë kontratën e qera-marrjes, të shoqëruar me certifikatën e pronësisë të mjetit, lejen e qarkullimit të qiradhenesit, sigurimin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të kërkojnë operatorit i kualifikuar i pari, para se të publikohet njoftimi i fituesit paraprak ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

*Kriteri i mesipërme u vendos duke patur parasysh përcaktimin e bërë në specifikimet teknike që: gazi do të levrohet me autobus në kaldajën e “Qytezës së Femijëve” Korçë.*

*Për sa më sipër është e nevojshme vendosja e kriterit për disponimin e një autoboti i cili duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim në mënyrë që të realizohet me sukses furnizimi i kaldajës me gaz.*

**2.2.5** Deklaratë në bazë të së cilës merr për sipër furnizimin me gaz, sipas standarteve në fuqi, me autobotin e tij dhe shpenzimet e tij deri në vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mesipërme është vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 8, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Kriteri i mesipërme u vendos me qëllim të garantohet furnizimin me gaz sipas kushteve të autoritetit kontraktor.*

## **II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Specifikimet teknike, kriteret e vecanta te kualifikimit, llogaritja e sasise dhe fondit limit, jane hartuar dhe derguar nga Qendra Sportive Korce, me shkrese Nr 98/1 Prot date 17/11/2025 protokolluar me Nr 11683/2 prot. dt 17.11.2025.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**